

VENDIM
Nr. 445, datë 22.7.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË QYTETIT TË
DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 17 543 430 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 17 543 430 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2021.

5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Bashkia Durrës.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Durrës.

8. Bashkia Durrës të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Durrës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT
“ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË QYTETIT TË DURRËSIT”**

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloj i pasurisë	Sip.	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lek/ m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
					Totale/ m²				
1	Dafina Musli Driza	1574	113/6	Vresht	3700	3700	397	1,468,900	Konfirmuar nga DVASHK-ja
2	Banush Berberi	1574	113/8	Ullishte	2947	2947	397	1,169,959	Konfirmuar nga DVASHK-ja
3	Margarita Mihal Kondakçi	1574	113/9	Ullishte	683	683	397	271,151	Konfirmuar nga DVASHK-ja
4	Laz Mihal Berberi	1574	115/3	Ullishte	2947	2947	397	1,169,959	Konfirmuar nga DVASHK-ja
5	Jorgji Mihal Berberi	1574	115/4	Ullishte	2947	2947	397	1,169,959	Konfirmuar nga DVASHK-ja
6	Sotir Mihal Berberi	1574	115/5	Ullishte	2947	2947	397	1,169,959	Konfirmuar nga DVASHK-ja
7	Margarita Mihal Kondakçi	1574	115/6	Ullishte	1459	1459	397	579,223	Konfirmuar nga DVASHK-ja
8	Lina Çerma.	1574	115/7	Arë	2440	2440	397	968,680	Konfirmuar nga DVASHK-ja
9	Marjana Driza	1574	115/8	Arë	2440	2440	397	968,680	Konfirmuar nga DVASHK-ja
10	Miltiadh Berberi.	1574	115/9	Arë	1520	1520	397	603,440	Konfirmuar nga DVASHK-ja
11	Andrea Berberi	1574	116/1	Arë	2440	2440	397	968,680	Konfirmuar nga DVASHK-ja
12	Bashkëpronësi të Lina Cerma, Andrea Berberi, Marjana Driza, Miltiadh Berberi	1574	116/2	Arë	2440	2440	397	968,680	Konfirmuar nga DVASHK-ja
13	Miltiadh Berberi	1574	116/3	Arë	920	920	397	365,240	Konfirmuar nga DVASHK-ja
14	Miltiadh Vangjel Berberi	1574	120	Arë	3100	3100	397	1,230,700	Konfirmuar nga DVASHK-ja
15	Bashkëpronësi të Lirije Baci, Petrit Hoxha, Pranvera Hoxha, Rakip Hoxha, Avni Hoxha, Suad Hoxha, Kremlina Hoxha (Tati), Teuta Hoxha, Lindita Hoxha (Dhora), Artan Hoxha	1574	138/12	Arë	4000	4000	397	1,588,000	Konfirmuar nga DVASHK-ja
16	Astrit Vesel Doka	1574	138/6	Vresht	4000	4000	397	1,588,000	Konfirmuar nga DVASHK-ja
17	Sherif Sula	1574	138/14	Vresht	1000	1000	397	397,000	Konfirmuar nga DVASHK-ja
18	Murat Sharka	1574	138/15	Vresht	2260	2260	397	897,220	Konfirmuar nga DVASHK-ja
Vlera totale					44,190.0	44,190		17,543,430	

Shënime:

1. Për tokën “arë”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

